



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8256/162 Prot

Shkodër, më 6 . 6 .2022

MARRËVESHJEKUADËR

PËR SHËRBIME ME OBJEKT: MBËSHETJE E EKIPIT TË MUNDJES MESHKUJ TË RRI TUR

Kjo marreveshje lidhet sot, më datë ___ / ___ /2022 ndermjet:

BASHKISË SHKODËR me adresë Rr. "13 Dhjetori", Nr 1, Shkodër, përfaqësuar nga **Z. Bardh Spahia**, në cilësinë e titullarit të Institucionit, në vijim referuar edhe si "**Bashkia**"

dhe

SHOQATA SPORTIVE "VILAZNIA - MUNDJE" me seli Pallati i Sportit "Qazim Dervishi"- Shkodër, përfaqësuar nga z. Nazmi Elezi me nr. NIPT-i M26517131U, në cilësinë e kryetarit të shoqatës, në vijim referuar edhe si "**Ekipi i Mundjes Vllaznia**".

Bashkia dhe Subjekti fitues do të referohen në vijim edhe si "Pala" ose "Palët".

Duke qënë se Palët:

Vlerësojnë rëndësinë e promovimit të territorit, përmes aktiviteteve sportive.

Marrin në konsideratë politikat zhvillimore të Bashkisë Shkodër në drejtim të organizimit të aktiviteteve që synojnë organizimin dhe mbështetjen e aktiviteteve sportive, që favorizojnë rritjen e zhvillimin e jetës sportive në territorin e Bashkisë Shkodër.

Synojnë realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Njohin eksperiencën e Shoqatës Sportive "Vllaznia - Mundje", në organizimin e aktiviteteve të sportive në Shqipëri.

Konfirmojnë angazhimin institucional për të bashkëpunuar në vijim të projektit "Mbështetje e ekipit të mundjes meshkuj të rritur".

Neni 1

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al Tel: 425922400150



Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil ligji nr.7850, datë 29.07.1994, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- 1.3 Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, i ndryshuar;
- 1.4 Ligji nr. 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar;
- 1.5 VKM nr.354, dt 29.8.1994 "Për shpërblimin e cilësisë të veprimtarive sportive, për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime te tjera sportive”, i ndryshuar
- 1.6 VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”;
- 1.7 VKB nr. 18 datë 25.03.2021 “Për vazhdimin e financimit të disiplinave sportive sipas PBA 2021-2023, programi ‘Sport dhe Argëtim’, përmes metodologjisë LOD, pas mbylljes së funksionimit të klubit sportiv ‘Vllaznia’ ”.
- 1.8 Urdhër nr. 407, datë 17.05.2022 “Për zbatimin e projekteve të shpallura fituese në thirrjen publike për organizatat e shoqërisë civile, sipas udhëzuesit për zbatimin e projekteve në kuadër të metodologjisë LOD, Programi Reload.
- 1.9 VKB nr. 3 datë 5.1.2022 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2022-2024 të Bashkisë Shkodër”;
- 1.10 VKM nr 789, datë 15.12.2021 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe trajtimin e sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë, dhe trajnerëve të tyre”.

Palët së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje si më poshtë vijon:

Neni 2

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Shoqatës Sportive “Vllaznia - Mundje”, për zbatimin e projektit “**Mbështetje e ekipit të mundjes meshkuj të rritur**”, të gjithë ekipeve zinxhir me synimin e zhvillimit të sportit të mundjes në Bashkinë e Shkodrës dhe të marrë pjesë në kampionate kombëtare në të gjitha kategoritë sportive të mundjes.

Neni 3

Objekti i Marrëveshjes

1. Mbështetje në pjesëmarrjen në kampionate dhe kupa kombëtare e ndërkombëtare të ekipit të Mundjes meshkuj të rritur e të rinj
2. Masivizim i sportit të mundjes



Neni 4
Afati i Marrëveshjes

4.1 Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 15 (pesëmbëdhjetë) muaj.

Neni 5
Vlera e Marrëveshjes

5.1 Marrëveshja lidhet për një vlerë totale prej 971 000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh.

5.2 Financimi realizohet sipas viteve në lekë:

Viti 2022: 647 000 lekë
Viti 2023: 324 000 lekë.

5.3 Kontratat do të lidhen çdo vit buxhetor.

Neni 6
Dispozita të tjera

19.1 Pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj marrëveshjeje do të jenë:

- Projekt Propozimi.
- Buxhetin bashkelidhë.
- Plani i aktiviteteve në një periudhë të caktuar kohore.

19.2 Kjo marrëveshje do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

19.2.1 Kjo marrëveshje u hartua në 4 kopje nga të cilat njëri e merr Subjekti fitues ndërsa tre të tjerat i mban Bashkia Shkodër.

PËR BASHKINË SHKODËR

Kryetar
Bardh Spahia



PËR SHOQATËN

Kryetar
Nazmi Elezi

